



KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES ME SHKËMBIM NOTASH, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE ORGANIZATËS PËR BASHKËPUNIM DHE ZHVILLIM EKONOMIK (OECD), PËR BËRJEN PALË NË KUADRIN GJITHËPËRFSHIRËS TË PROJEKTIT NDËRKOMBËTAR MBI EROZIONIN E BAZËS SË TATUESHME DHE TRANSFERIMIN E FITIMIT (BEPS)”

I. HYRJE

Komisioni për Politikën e Jashtme, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), për bërjen palë në kuadrin gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar mbi erozionin e bazës së tatueshme dhe transferimin e fitimit (BEPS)”.

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve ishin përfaqësues të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë.

II. QËLLIMI DHE PERMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Qëllimi i projektligjit është ratifikimi i marrëveshjes me shkëmbim notash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), për bërjen palë në kuadrin gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar BEPS mbi erozionin e bazës së tatueshme dhe transferimin e fitimit.

Ky projektligj vjen pas miratimit në parim të marrëveshjes, me Vendimin Nr.628, datë 26.10.2018, të Këshillit të Ministrave.

Nëpërmjet ratifikimit të kësaj marrëveshjeje Shqipëria merr angazhimin për plotësimin e standarteve minimale të paketës BEPS, një projekt ndërkombëtar dhe gjithëpërfshirës, i cili, i zhvilluar së bashku me anëtarët e OECD-së, ka si synim arritjen e tre objektivave kryesorë:

- Përforcimin e koherencës së rregullave të tatimit mbi të ardhurat e korporatave në nivel ndërkombëtar;
- Lidhjen e tatimit me përmbajtjen e aktiviteteve ekonomike të realizuara;
- Përmirësimin e transparencës.

Gjithashtu kjo marrëveshje vjen edhe në përmbushje të angazhimit të Shqipërisë ndaj Komisionit Evropian, se vendi ynë do të jetë pjesë e kuadrit gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar BEPS në vitin 2019.

Projekti BEPS do të ofrojë për Shqipërinë dhe vendet anëtare:

- Zhvillimin e standardeve në lidhje me çështjet e BEPS-së;
- Rishikimin dhe implementimin e standardeve minimale nëpërmjet një sistemi efektiv monitorimi;
- Një forum për vendet që të nxjerrin në pah sfidat në zbatimin e standardeve ndërkombëtare dhe të gjejnë zgjidhje të reja, kryesisht për vendet në zhvillim;
- Lehtësimin e procesit të implementimit duke ofruar orientim të mëtejshëm dhe suport për vendet në zhvillim, duke përfshirë rritjen e kapaciteteve dhe drejtimin sipas platformës së bashkëpunimit për tatimet, e ngritur kjo nga organizatat ndërkombëtare.

Nëpërmjet këtij programi bëhet e mundur që shtetet anëtare të mund të marrin mbështetje të koordinuar dhe më të orientuar për ndërtimin e kapaciteteve në zbatimin e rezultateve të BEPS-së nga organizatat ndërkombëtare dhe rajonale.

Ky raport shikon mundësinë e arritjes së një marrëveshjeje shumëpalëshe të përbashkët, që bën të mundur përfshirjen e masave BEPS në këtë marrëveshje, si dhe amendimin e marrëveshjeve dypalëshe të taksimit të dyfishtë pa qenë nevoja e amendimit të tyre një nga një me secilin shtet kontraktues.

Për sa i takon **efekteve financiare** në buxhetin e shtetit, pjesëmarrja në kuadrin gjithëpërfshirës të BEPS-së kërkon pagesën e **një tarife vjetore prej 20 200 eurosh**.

III. DISKUTIMI NË KOMISION

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit, për të shpjeguar nismën dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve, ishin përfaqësues të përfaqësues të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë. Deputetët në komision u informuan rreth qëllimit të projektligjit dhe kushteve të parashikuara në marrëveshje. Përfaqësuesit e ministrisë sqaruan se pjesëmarrja në kuadrin gjithëpërfshirës të këtij projekti ndërkombëtar i jep mundësinë vendeve anëtare të punojnë në mënyrë të barabartë në trajtimin e shmangies tatimore, të përmirësojnë koherencën e rregullave të marrëveshjeve tatimore dhe të sigurojnë një ambient tatimor sa më transparent, si dhe thkesuan rëndësinë e ratifikimit të marrëveshjes duke marrë parasysh detyrimin e Shqipërisë për përmbushjen e angazhimeve ndaj Komisionit Evropian.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni me votat e shumicës së anëtarëve të pranishëm e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe u shpreh dakord për kalimin e tij për votim në seancë plenare.

RELATORE

KRYETARE

EGLANTINA GJERMENI

MIMI KODHELI